

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile vijon veprimtarinë e saj me një program të dytë 2022-2025!

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB) do të vijojë ofrimin e shërbimeve për sektorin dhe të gjithë aktorët e interesuar edhe për tre vitet e ardhshme.

Nisma zbatohet nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim sërish në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA), me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Nga 2019 e në vazhdim Qendra ka konsoliduar rolin e saj si një platformë për shoqërinë civile në nivel kombëtar e lokal, në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve të sektorit, nxitjes dhe lehtësimit të dialogut në politikëbërje dhe përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues.

Në tre vitet e ardhshme, përmes zyrave në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, shërbimeve online si dhe aktiviteteve në qytete të ndryshme të vendit, do të mbështesim organizatat e shoqërisë civile, rrjetet e OSHC-ve, grupimet informale, aktivistët dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile me një gamë të gjerë shërbimesh të konsoliduara por dhe programe të reja dizenuar posaçërisht në përgjigje të nevojave të identifikuara në sektor.



Shërbime Help Desk

Informacion

mbi (i) Sektorin jofitimprurës, kuadrin ligjor dhe zhvillimet e sektorit për OSHC-të, rrjetet e OSHC-ve, donatorë, institucione, dhe aktorë të tjerë të interesuar brenda dhe jashtë vendit; (ii) Mundësi financimi në vend, rajon, Evropë e më gjerë në nivel global; (iii) Procese konsultuese të institucioneve në nivel qendror e vendor, Parlamentit, donatorëve etj., (iv) Evente publike të hapura për pjesëmarrje për OSHC-të etj.

Asistencë direkte dhe online

për organizatat dhe rrjetet e OSHC-ve për të adresuar nevojat e tyre.



Shërbim ligjor për organizatat e shoqërisë civile, grupimet informale të aktivistëve.

Si pjesë këtij shërbimi Qendra Burimore do të ofrojë:

- (i) **Informim dhe Edukim Ligjor për OJF-të** lidhur me aksesin në institucionet e administratës publike, aksesin në sistemin gjyqësor të subjekteve OJF, udhëzime të përgjithshme për formalitet e kërkesave / kërkesë-padive, procedurat, etj.
- (ii) **Këshillim ligjor në lidhje me:** krijimin, funksionimin, çregjistrimin ligjor për OJF; licencimin e OJF-ve, regjimin tatimor për OJF (veprimtari jofitimprurëse jo-ekonomike dhe ekonomike); detyrime të OJF për deklarime dhe raportime; legjislacioni AML dhe CFT (kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit) i zbatueshëm për OJF; OJF-të si punëdhënës dhe në marrëdhëniet me vullnetarët; marrëdhëniet kontraktore, përfshirë kontrata financimi etj.

Më shumë informacion lidhur me këtë shërbim dhe si mund të përfitoni prej tij gjendet [këtu](#)



Rrjetëzim për organizatat e shoqërisë civile

në nivel lokal, kombëtar, rajonal e më gjerë. QKB do të vazhdojë pasurimin e [Direktorisë online të OSHC-ve](#) në faqen e internetit të Qendrës Burimore; pasurimin e informimit për rrjete organizatash në vend, rajon e më gjerë si dhe organizimin e eventeve rrjetëzuese.



Ndërmarrje e nismave advokuese, lehtësim i përpjekjeve advokuese të sektorit dhe dialogut ndërinstytucional

për një pjesëmarrje më të madhe dhe më efektive në politikëbërje dhe zbatim.



Mbështetje për OSHC-të për arritjen e standardeve më të larta

në qeverisjen e organizatave; manaxhimin e burimore njerëzore dhe financiare; transparencën dhe llogaridhënien ndaj përfituesve, anëtarëve e mbështetësve; advokimin e përgjegjshëm dhe ndërtimin e partneriteteve dhe rritjen e besimit të publikut.

Qendra Burimore do të vijojë të shërbejë si **Sekretariat i Kodit të Standardeve për OSHC-të në Shqipëri**, duke synuar të përmirësojë efektivitetin e punës së organizatave jofitimprurëse dhe rritjen e besimit të publikut në sektor.



Fuqizim kapacitetesh për organizatat dhe rrjetet e OSHC-ve.

Bazuar në vlerësime të përvitshme të nevojave të sektorit si dhe në kërkesa të organizatave apo nevoja që lindin nga zhvillimi i dinamikave lidhur me sektorin dhe jo vetëm, Qendra Burimore ka dizenuar një sërë programesh trajnimi dhe asistence për periudhën 2022-2025.

Programe në vijim



Akademia e OJF-ve, një program vjetor që kontribuon në rritjen e kapaciteteve të drejtuesve dhe manaxherëve të OJF-ve. Inicuar që prej vitit 2015 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Akademia e OJF-ve është konsoliduar si një program edukimi dhe zhvillimi joformal për përforcimin e aftësive dhe kompetencave të drejtuesve dhe manaxherëve të organizatave të shoqërisë civile në mbarë vendin, nëpërmjet një kurrikule unike, metodave më bashkëkohore të të nxënimit si dhe përvojave shumëdimensionale të shkëmbimit të eksperiencave nga vendi, rajoni, Evropa e më gjerë.



Programi i Asistencës Teknike për Rrjete, Koalicione dhe Grupime Informale të OSHC-ve, në mbështetje të zhvillimit të tyre institucional dhe iniciativave advokuese.



Programe trajnimi rajonale dizenuar sipas kërkesave të OJF-ve apo bazuar në vlerësimet periodike të nevojave që Qendra Burimore kryen. Për vitin 2022 trajnimet kryesisht do të fokusohen në ngritjen e fondeve[i] dhe përdorimin e mënyrave alternative (Crowdfunding etj.) që sigurojnë më shumë mbështetje dhe qëndrueshmëri për organizatat lokale.



Programe të reja



“Manaxhim dhe monitorim i granteve”- program trajnimi dizenuar për organizata të cilat ofrojnë mbështetje financiare për OSHC të tjera, përmes skemave të ndryshme të nëngrantimit kryesisht me fonde të BE-së dhe donatorëve të tjerë;



“Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet” - program afatgjatë trajnimi dhe mentorimi për organizata të interesuara në zhvillimin e strategjive dhe planeve në ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave nga produkte dhe shërbime konkrete me pagesë. Si pjesë e programit do të mundësohen takime OSHC-Biznese me qëllim krijimin e urave të bashkëpunimit dhe eksplorimin e mundësive konkrete të partneritetit mes dy sektorëve.



“Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE” - programe rajonale trajnimi dhe mentorimi të OSHC-ve nga mbarë vendi për të rritur njohuritë dhe procesit të akreditimit për t'u bërë pjesë e programeve të vullnetarizmit në nivel Evropian.



“EU aquis, angazhimi dhe roli i OSHC-ve në procesin e integritit të vendit në BE” - programe rajonale periodike trajnimesh për forcimin e mëtejshëm të njohurive të OSHC-ve dhe rritjen e kontributit të tyre në grupet ndërinstitucionale të punës, përgjatë fazave të procesit të integritit evropian dhe negociatave për pranimin në BE.

Një risi tjetër e programit të QKB në këto vite, është dhe organizimi i **“Javës Kombëtare të Shoqërisë Civile”** dedikuar sektorit për të promovuar punën dhe kontributin e tij. Me një seri eventesh organizuar nga OSHC-të në të gjithë vendin, Java do të ofrojë më shumë mundësi rrjetëzimi e dialogu ndërinstitucional për çështje me rëndësi për sektorin dhe zhvillimin e vendit.



info@resourcecentre.al



[@resourcecentre.al](https://www.facebook.com/resourcecentre.al)



<https://resourcecentre.al>

[1] Bazuar edhe në gjetjet e Vlerësimit Vjetor të Gjendjes së Mjedisit Mundësues dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, përkundrejt Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020, në kuadër të projektit të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO 3) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, financuar nga Bashkimi Evropian.